



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi \_ dhe nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit anonim për korrupsion Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), në seancën e 47 të mbajtur me datë 31.03.2021 morri

#### VENDIM

Procedura për lëndën numër 12-4564 nga viti 2019, e formuar pas denoncimit anonim nr. 12-4563/1 me datë 02.10.2019 dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nga qytetarët vllhë të qyteti të ..... dhe respektues të tyre në rastin, NDËRPRITET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për lëndën me numër 12-4564 nga viti 2019.

Lënda me numër 12-4564 nga viti 2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK me sqarimin në formë të depersonalizuar të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej pesë ditë nga dita e marrjes së vendimit.

#### SQARIM

Lënda me numër 12-4564 nga viti 2019 është e formuar pas denoncimit anonim nr. 12-4564/1 me datë 02.10.2019, dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nga qytetarë vllhë të qytetit ..... dhe përkrahës të tyre dhe respektues të rastit.

Në denoncim flitet për akuza kundër Kishës ortodokse Maqedonase dhe Regjistrin qendror të RMV, për marrjen joligjore të pronësisë të Kishës ..... , e cila është e njohur edhe si Kisha vllhe dhe ka qenë kishë ortodokse të komunitetit vllhë në ..... e cila në mënyrë joligjore është regjistruar edhe në Agjensionin për kadastrë të patundshmërive – Filiala në ..... Në shtojcë të denoncimit janë dorëzuar 376 nënshkrime nga qytetarë përkrahës të rastit. Nga KSHPK dhe institucioneve tjera deri tek të cilët është e adresuar denoncimi i parashtruar, kërkohet që të zgjidhet ky problem dhe kisha të kthehet në pronësi të pronarëve të vjetër, gjegjësisht të Komunitetit të vllhëve ..... nga .....

Gjatë shqyrtimit të rastit të lëndës KSHPK i merr parasyshtë akuzat e parashtrusit dhe në drejtim të përcaktimit të gjendjes faktike dorëzoi kërkesë deri tek Agjensionin për kadastrë të patundshmërive – Njësia e kadastrës së patundshmërive ....., për dorëzim të të dhënave dhe informacioneve në lidhje me rastin e lëndës. Pas kërkesës nga Komisioni shtetëror është dorëzuar informim dhe pas rishikimit të dokumenatacionit të plotë për rastin e lëndës, nga ana e KSHPK është vërtetuar gjendja faktike vijuese:

- Në rastin konkret bëhet fjalë për objekt – kishë e cila është udhëhequr në pronësi të Komunitetit të vllhëve ..... nga ....., e cila mbrenda natës në ..... kadastrë ka kaluar në pronësi të Kishës ortodokse maqedonase, gjegjësisht Mitropolisë në .....

- ..... Akuzat e lëndës të parashtruesit se kjo kishë pasiqë është ndërtuar në vitin 1903 çdo herë ka qenë e vllhëve kurse nga Komuniteti i vllhëve ..... të cilët kanë qenë edhe përfaqësues zyrtar dhe të regjistruar si përfaqësues të vllhëve thojnë se në vitin 2016 ka ndodhur një moskuptim me Kishën ortodokse maqedonase, më konkretisht me mitropolitin ..... dhe atëherë ka ndodhur ky problem me pronësinë e cila sipas tyre është marrë me dokument joligjor e cili nuk ka qenë akt juridik dhe me urdhëresë të Regjistrit qendror. Parashtruesit e denoncimit kërkojnë nga të gjithë organet kompetente deri tek të cilët u drejtuan që një ditë e më parë kisha t’i kthehet komunitetit të vllhëve.
- Në lidhje me rastin e lëndës ka edhe shpallje në medime me datë 27.10.2016, në të cilën sqarohet për problemin e theksuar dhe kanë shprehur për akuzat të cilat janë lëndë të dorëzuara deri tek KSHPK.
  - Me datë 26.02.2020, me kërkesë të KSHPK, nga ana e Agjencionit për kadastër të patundshmërive – Njësia për kadastër të patundshmërive ....., janë dorëzuar të dhëna – vërtetim për rishikim historik për regjistrimet e bëra për parcelën e kadastrës në të cilën është e evidentuar objekti i lëndës – kisha. Nga shqyrtimi i bërë në të dhënat e dorëzuara është kosntatuar se:
    - o Prona e lëndës në vitin 1954 është regjistruar në emër të personit fizik kurse pas nacionalizimit të pronës në vitin 1954 është regjistruar si pronë e RPFJ ..... Me regjistrimin e ri nga viti 1972 nga kjo pronë janë formuar dy parcela kadastrale dhe nga nja prej tyre me sipërfaqe prej 242 metra katrorë është formuar parcela e re në fletëpronësi të Kishës ortodokse romake Shën ..... dhe ....., kurse në vitin 1993 në bazë të fletparaqitjes për ndryshim të titullit e njëjta është regjistruar në fletëpronësi në emër të Kishës Ortodokse vllhe të komunitetit vllhë ..... nga .....
    - o Me regjistrimin e ri në vitin 2008, përsëri nga parcela në të cilën është regjistruar kisha dhe një pjesë e vogël nga parcelë tjetër është formuar parcelë e re e regjistruar fletëpronësi kisha 13 me me të drejtë prone të papërcaktuar.
    - o Në vitin 2010, në bazë të vërtetimit nga ANK ..... vërtetim nga libri intabulacion, elaborati gjeodezik, parcela e sapoformuar kalon dhe regjistrohet në FP ..... të RM me pjesëmarrje 1/1, shfrytëzues i tokës është Kisha ortodokse vllhe nga Komuniteti vllh ..... nga ..... – Kisha shën. ...., kurse objekti – kisha regjistrohet në FP ..... në emër të Kishës ortodoks vllhe të komunitetit vllhë ..... nga ..... – Kisha shën. ...., dhe atë kati i parë të ndërtesës.
    - o Në vitin 2016 në fletëpronësinë është shënuar kërkesë për privatizim zë tokës në pronësi shtetërore, nga Komuniteti vllhë - ..... lënda nr. .... / ..... me datë 20.10.2010. Vitin e njëjtë, me shkrim – gjendja rrjedhëse nga Regjistri qendror i RM me datë 04.03.2016 parcela kadastrale e lëndës – FP ..... ngel në pronësi të RM por si shfrytëzues të tokës me pjesëmarrje 1/1 është regjistruar Kisha ortodokse maqedonase – Arqipeshkia e Ohrit PPPE – Kisha shën ..... kurse përsëri me gjendjen e njëjtë rrjedhëse nga Regjistri qendror – kisha e cila është regjistrua në FP ..... ka pësuar ndryshim në titullin dhe është regjistruar në 1/1 të Kishës ortodokse maqedonase – AO – PPPE – Kisha shën ..... dhe kjo pozitë në PK dhe të objektit kanë qenë të

njëjta deri në ditën e dorëzimit të përgjigjes deri tek KSHPK, deri me datë 26.02.2020.

Nga e konstatuara, del se me ndryshimin e evidencës kadastrale në vitin 2016 e cila është bërë në bazë të gjendjes rrjedhëse nga Regjistri qendror numër ...../..... me datë 04.03.2016 toka ka ngelur në pronësi të RM vetëmse është ndryshuar shfrytëzuesi dhe shfrytëzuesi i së njëjtës ka ngelur Kisha ortodokse maqedonase, kurse objekti – kisha ka pësuar ndryshim dhe e njëjta është regjistruar në emër të Kishës ortodokse maqedonase.

Nga të dhënat e dorëzuara nuk mund të konstatohet se çka ka ndodhur me kërkesën për privatizim të tokës në pronësi shtetërore, parashtruar nga komuniteti vllahë ..... e cila është evidentuar si lëndë me numër ...../..... me datë 20.10.2010 e cila është e shënuar si e tillë në evidencën kadastrale për PK të lëndës me numër ..... e videntuar me FP ..... Palët e kyçura, komuniteti i vllahëve - ....., ka mundur të nge edhe procedurë gjyqësore në bazë të rastit të lëndës, mirëpo KSHPK nuk ka mundësi të siguron informacione plotësuese përshkak që denoncimi i parashtruar është anonim.

Në bazë të gjendjes faktike të përcaktuar, në rastin e lëndës nuk është konstatuar shkeqje të ligjit, gjegjësisht ndryshimet në parcelën kadastrale të lëndës dhe objektit në evidencën kadastrale kanë pësuar/ndryshuar në bazë të dokumentacionit të dorëzuar nga ana e organeve kompetentet dhe paashtruesit të denocimit si palë e kyçur në rastin ka mundur të nge procedurë gjyqësore ose procedurë tjetër, dhe njëherit KSHPK nuk ka mundësi të siguroj materiale shpesh për rastin sepse denoncimi i parashtruar është anonim. Duke pasë parashyshëm të shënuarën, KSHPK nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshën në rastin e lëndës, procedura për lëndën të ndërpritet kurse lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke pasë parasysh të shënuarën mësipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi sipas dispozitave të këtij vendimit.

**KOMISIONI SHTETËRORE PËR  
PARANDALIM TË KORRUPTIONIT**  
Kryetarë: Biljana Ivanovska

Dorëzuar deri tek: Arkiva,  
Pas përfundimit të senacës së KSHPK  
Përpunoi: J. C., këshilltarë  
Miratoi: m-r Sh. S., anëtarë i KSHPK